

VENDIM
Nr. 155, datë 28.9.2017

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S, NR. 90, DATË 7.6.2017, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PÛRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SHA, PËR PERIUDHËN 5.1.2017–20.9.2017” DERI MË 31.12.2017

Në mbështetje të neneve 13, pika 2, 17, pika 1, germa “e” dhe 33 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.9.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe të Tarifave, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 5.1.2017–20.9.2017” deri më 31.12.2017,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”.

- ERE, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, vendosi certifikimin paraprak të shoqërisë “Albgaz” sh.a., si operator i kombinuar i gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet përkatëse të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Me anë të shkresës nr. 4, datë 20.2.2017, “Albgaz” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror, bazuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave 848, datë 7.12.2016.

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 90, datë 7.6.2017, vendosi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për shoqërinë “Albgaz” sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 85, datë 28.8.2017, dërgoi në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimit nr. 90, datë 7.6.2017, të bordit të ERE-s, për të mos penguar vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë për periudhën në vazhdim.

- Me vendimin nr. 127, datë 16.8.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- Me vendimin nr. 142, datë 6.9.2017, filloi procedurën mbi miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit.

- ECRB-ja e bën të domosdoshme lënien në fuqi të vendimit nr. 90, datë 7.6.2017, duke shprehur opinionin e saj me anë të *email*-it të datës 26.9.2017, se shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet ushtrojë aktivitetin e saj konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe direktivave të komunitetit të energjisë, duke argumentuar se rregullimi i aksesit në rrjet duhet të jetë i garantuar dhe shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 5.1.2017–20.9.2017” deri më 31.12.2017.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të “Albgaz” sh.a., përditësimi dhe kompensimi i tyre do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr.

102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3. Drejtoria e çmimeve dhe tarifave të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti